

ETIKA PROFESIONALE DHE KOMUNIKIMI,
PRAKTIKA INFERMIERORE,
PROMOVIMII SHËNDETIT DHE PARANDALIMI I SËMUNDJES,
PROÇESI INFERMIEROR DHE QARKULLIMI.

1. Cili është misioni i Urdhërit të Infermierit të Shqipërisë?
 - a. Përcakton përjasje të reja për të gjithë infermierët e Shqipërisë
 - b. Ruajtja e standarteve të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe mbrojtja e pacientëve nga kequshtrimi i profesionit
 - c. Përpilimi i standarteve të praktikës infermierore
 - d. Përcaktimi i kornizës profesionale brenda të cilës infermierët ushtrojnë praktikën e tyre profesionale

2. Sipas statusit të përcaktuar me ligj Urdhëri i Infermierit:
 - a. Është një ent publik
 - b. Është ent publik jobuxhetor që përfaqëson interesat e përbashkëta të profesioneve infermier, mami, fizioterapi
 - c. Është organizatë profesionale që ndihmon në zhvillimin e profesionit infermier në Shqipëri.

3. Cili organ rregullon veprimtarinë e Urdhërit të Infermierit
 - a. Statuti
 - b. Rregulloret
 - c. Parlamenti
 - d. Presidenti

4. Sipas dispozitave në fuqi infermieri, mamia, fizioterapeuti janë:
 - a. Profesionistë të kujdesit shëndetsor të pajisur me diplomë
 - b. Profesionist i kujdesit shëndetsor pa diplomë
 - c. Nuk është profesionist në shëndetsi
 - d. Varet nga Urdhëri i Mjekut

5. Cili është burimi financiar i Urdhërit të Infermierit
 - a. Nuk ka burime financiare
 - b. Kuotizacionet e anëtarëve, tarifat e regjistrimit dhe donacione të ndryshme
 - c. Financimet e mbledhura në formë ndihme
 - d. Ministria e Shëndetësisë dhe Fakulteti i Infermierisë

6. Një Kod Etik është:
 - a. Një guide profesionale e lëshuar nga një organizatë për anëtarët e saj, që i ndihmon ata të zgjedhin veprimet e tyre në lidhje me vlerat primare dhe standartet e etikës

- b. Një rregullore e miratuar me ligj
- c. Një reviste profesionale
- d. Nuk lidhet me profesionin infermieror

7. Kodi etik i infermierëve:

- a. Udhëheq infermierët drejt zhvillimit të identitetit profesional
- b. I shërben Urdhërit të Infermierit
- c. Nuk është një instrument komunikimi
- d. Nuk është i detyruar që të ndiqet nga të gjithë

8. Cila nga vlerat e më poshtme është vlerë bazë për mbrojtjen e pacientit?

- a. Pacientët janë qenie holistike dhe autonome
- b. Infermierët janë përgjegjës për plotësimin e të gjitha nevojave të pacientit
- c. Pacientët mund të zgjidhin problemet e tyre vetëm në mënyrë të pavarur
- d. Infermieri punon i pavarur për zgjidhjen e problemeve të pacientit

9. Cilat nga të mëposhtmet janë qëllimet e kodit etik të infermierit?

- a. Informon publikun për standartet profesionale, drejton profesionin dhe tregon përkushtim në shërbim të publikut
- b. Siguron formula për marrjen e vendimeve, informon publikun për minimumin e standarteve të kujdesit dhe praktikës dhe kujton infermieret për përkushtimin e tyre ndaj shërbimit publik
- c. Siguron rregullator dhe rregulla për të menaxhuar problemet etike për të drejtuar profesionin drejt autonomisë në praktikë dhe informon publikun për shërbimet profesionale
- d. Siguron informacion rreth shërbimeve të ofruara për publikun si dhe standartet e kujdesit

10. Kur një infermiere është e aftë që të ndajë dhe ta balancojë kohën e shpenzuar me pacientët e saj në varësi të nevojave të tyre infermierja po aplikon principin moral të:

- a. Mosdëmtimit me qëllim
- b. Drejtësisë
- c. Përfitimit
- d. Vërtetësisë

11. Kur infermieri nuk arrin të mbajë premtimin që i bëri pacientit, si për shembull kthimin për t'i dhënë një informacion ose takimi i një personi tjetër të stafit për ta, infermieri po shkel principin :

- a. Besueshmërisë
- b. Autonomisë
- c. Përfitimit
- d. Përgjegjësisë

12. Cila nga strategjitë e mëposhtme do të ndihmojë infermierin të praktikojë në mënyrë etike?

- a. Të pranojë të gjitha kritikatat

- b. Të shmangë verbalizimin e mendimit të tij/saj
 - c. Të shmangë diskutimin e vlerave dhe besimeve të pacientit me kolegët
 - d. Të jetë i vetëdijshëm për vlerat e tij/saj dhe aspektet etike të infermierisë
13. Një infermiere i thotë një klienti “Ju duhet të merrni mjekimin”. “Nëse nuk e merrni do t’u bëj një gjilpërë”. Cila nga të mëposhtmet përshkruan sjelljen infermiere si një veprim kundërligjit?
- a. Kërcënim gojor
 - b. Kërcënim me prekje
 - c. Burgim i rremë
 - d. Shkelje e rregullave të MSH
14. Një infermiere po përgatit një pacient për një procedurë kirurgjikale. Çfarë duhet të bëjë infermieri nëse konsenti kirurgjikal nuk është firmosur nga pacienti:
- a. Shpjegojë procedurën dhe rreziqet a saj pacientit dhe duke i dhënë formularin për ta firmosur
 - b. Njoftojë kirurgun se klienti ka nevojë për konsentin informues
 - c. Dërgon klientin në sallë me shënimin se konsenti nuk është firmosur
 - d. I thotë pacientit se formulari duhet të firmoset përpara ndërhyrjes kirurgjikale.
15. Një infermiere mendon se për pacientin është porositur një sasi e madhe medikamenti panvarësisht nga pesha e tij. Cilin veprim duhet të ndërmarrë infermieri në këtë rast:
- a. Administrojë një dozë më të vogël
 - b. Të pyesë kryeinfermierin se çfarë duhet të bëjë
 - c. Kontakton mjekun dhe sqaron urdhërin
 - d. Jep medikamentin sipas përshkrimit
16. Cili nga veprimet e mëposhtme infermiere është bazuar mbi principin etik të autonomisë?
- a. Heqja e rrugicës së tapetit në anë të shtratit të pacientit
 - b. Respektimi i refuzimit të trajtimit nga klienti
 - c. Thënja e të vërtetës klientit mbi diagnozën negative
 - d. Përdorimi i paternalizmit kur i përgjigjemi pyetjeve të klientit
17. Infermierja ka shumë role dhe funksione. Cila nga të mëposhtmet ilustron më së miri rolin si avokate e klientit?
- a. Të ndihmosh pacientin që të ushtrojë të drejtat e tij
 - b. Të ndihmosh klientin të njohë dhe përballojë situatat stresante
 - c. Të ndihmojë stafin dhe pacientët me ndryshimet që ndodhin në sistemin e kujdesit shëndetësor
 - d. Të influencojë të tjerët të punojnë së bashku dhe të arrijnë qëllimet
18. Qëllimi i dëshiruar i infermierisë është që të arrijë profesionalizmin. Cilët janë pjesët e nevojshme të një profesioni?

- a. Trup unik njohurisë, kodi i etikës profesionale, një diplomë universiteti, përshkrimi i punës për ata në profesion
 - b. Edukimi i specializuar, orientimi i serviseve, kërkim shkencor, autonomi, kod etike dhe organizata profesionale
 - c. Trajnime specializimi, kërkim shkencor, edukimi i avancuar dhe eksperiencia, standartet e kujdesit
 - d. Orientimi i serviseve, kërkimi shkencor, autonomia, kodi i etikës dhe organizata profesionale
19. Një pacient ndihet shumë i sëmurë dhe i dehidruar pasi ka marrë terapinë me kimeoterapi. Cila nga principet morale mund të shkelet nga përdorimi i kimioterapisë
- a. Besueshmërisë
 - b. Drejtësisë
 - c. Autonomisë
 - d. Mos dëmtimi i qëllimshëm
20. Nëse një mjek përshkruan një medikament me dozën dy herë më të madhe se sa dosa e sigurtë. Cili do të ishte veprimi i parë infermieror?
- a. Kontakto mjekun dhe diskuto përshkrimin
 - b. Raporto tek krye-infermiera
 - c. Refuzo të japësh mjekimin dhe dokumento arsyen
 - d. Kontakto shefin e pavionit
21. Një infermiere shikon se kolegia e saj kryen një procedurë në mënyrë të gabuar dhe të përsëritur. Infermiera është përpjekur disa herë, t'i tregoj koleges mënyrën korrekte të kryerjes së procedurës por kolegia vazhdon ta kryejë procedurën në mënyrë të pasigurtë. Çfarë duhet të bëjë më pas infermiera?
- a. Shkruan ngjarjen, e firmos dhe e raporton atë tek kryeinfermierja
 - b. Raporton incidentin së bashku me përpjekjen e saj për ta korrigjuar
 - c. I thotë kryeinfermieres më pas shkruan një raport
 - d. Raporton tek kryeinfermiera dhe më pas tek urdhri i infermierit
22. Një infermiere pa se mjeku foli me një paciente rreth procedurës kirurgjikale. Pasi pacienti firmosi konsentin mjeku largohet nga dhoma dhe kur infermierja hyn në dhomë pacienti i drejton asaj pyetje specifike që lidhen me procedurën. Cilin nga veprimet e mëposhtme duhet të ndërmarë infermierja?
- a. Flet me pacientin rreth procedurës
 - b. Pyet pacientin pse e firmosi konsentin kur nuk kuptoi çfarë do të ndodhte
 - c. Nuk ndërmer asnjë veprim pasi pacienti e ka firmosur konsentin
 - d. Njofton mjekun që të japë më shumë informacione tek pacienti

23. Infermieri dëgjoi një paciente që rrëshqiti dhe u përplas në dysheme, pacienti thotë se dyshemeja ishte e largur dhe ai rrëshqiti. Cili do të ishte veprimi më i përshtatshëm që do të ndërmerret infermieri?
- Infermieri duhet së pari të kujdeset për pacientin dhe më pas të dokumentojë ngjarjen, gjëndjen e dyshemesë dhe dëshmitarët e incidentit
 - Infermieri kërkon ndihmë, delegon kujdesin tek një person tjetër dhe dokumenton incidentin
 - Infermieri merret me klientin dhe raporton kujdesin e dhënë tek kryeinfermierja
 - Infermieri kërkon ndihmë dhe kujdeset për pacientin
24. Një pacient me demenc nervozohet kur infermieri po e përgatit për të kryer një banjo komplet. Cili do të ishte veprimi më i përshtatshëm infermieror?
- Prit gjysëm ore ose më shumë dhe më pas përpigu që ti bësh banjon
 - Shpjegoi nevojën e kryerjes së dushit përpara orarit të vizitave
 - Lëre banjon që ta kryejnë familjarët ditën tjetër
 - Ofroi klientit mjekime për ta qetësuar
25. Përpara se të performojë kujdesin oral tek një pacient të pavetëdijshëm, infermieri pozicionon pacientin:
- Në pozicion anash me kokën e krevatit ulur
 - Në pozicion Semi-Fouler
 - Në pozicion Trendelenburg
 - Në pozicion semi –pronë
26. Kur i demonstroi familjarëve kujdesin ndaj syve tek një pacient komatoz, infermieri pastron sytë duke filluar nga këndi i brendshëm tek këndi i jashtëm. Ajo e shpjegon këtë si:
- Parandalim të futjes së sklepave në kanalin nazolacrimon
 - Është më e lehtë që të mbahet mend nga dhënësi i kujdesit
 - Stimulon prodhimin e lotëve në gjëndrat lakrimale
 - Stimulon refleksin korneal
27. Një paciente femër ka polycythemia. Kjo do të tregonte se niveli i hemoglobinës (Hgb) dhe hematocritit (Hct) mund të jenë:
- Rritur
 - Ulur
 - Brenda kufijve normalë
 - E diskutueshme
28. Një mjek sapo ka marrë gjakun arterial për të matur nivelin e gazeve. Cili do të ishte veprimi më i përshtatshëm infermieror pas heqjes së agës?
- Monitoro për shenja shoku duke i matur shenjat vitale deri në dy orë pas procedurës
 - Monitoro marrjet dhe nxjerrjet për 24 orë
 - Apliko akull në vëndin e çpimit
 - Apliko presion në vëndin e çpimit për 5-10 minuta pas heqjes së agës

29. Një infermiere po mbledh një kampion urine nga kateteri. Ajo vëren se nuk ka urinë në kateter. Cili do të ishte veprimi më i përshtatshëm infermieror?
- Shpon kateterin me age dhe aspiron urinë
 - Bllokon tubin e drenimit me klamë për 30 minuta
 - I jep pacientit lëngje për të pirë
 - Bllokon kateterin me klamë për 30 minuta
30. Kur mbledh kampionin e sputumit infermieri duhet që:
- Pasi të mbledhë kampionin t'i ofrojë pacientit dicka për të pirë
 - I ofron klientit dicka për të pirë përpara se të mbledhë kampionin
 - Përdor maskë kur mbledh kampionin
 - I kërkon pacientit të marrë frymë thellë, dhe më pas të kollet për të nxjerrë 15-30mL sputum
31. Një pacient që po përgatitet për parecentezën pyet infermieret përse duhet të shkojë në banjo. Përgjigjia më e përshtatshme infermiere do të ishte:
- Fshigza qëndron mbi disa organe të abdomenit
 - Kur fshigza është e boshatisur ka më pak mundësi që të çpohet gjatë procedurës
 - Kjo është vetëm një mbrojtje në mënyrë që doktori të mos çpojë fshigzën
 - Kur fshigza është bosh mjeku e ka më të lehtë të shikojë nga vijnë lëngjet extra
32. Gjatë një punkcioni osal infermierja duhet të vlerësojë pacientin për:
- Zbehje, djersë dhe të fikët të lidhur me dhimbjen ose gjak rredhjen
 - Dispne, zbehje, kollë si shenjë e stresit
 - Dispne, zbehje, rënie e presionit të gjakut e lidhur me shokun
 - Puls jo normal, ngjyrë jo normale lëkure dhe shqetësim të lidhur me shokun
33. Cila nga aktivitetet e mëposhtme është promovim shëndeti i kryer nga infermieri?
- Administrimi i imunizimeve
 - Kryerja e një banjoje
 - Parandalimi i aksidenteve në shtëpi
 - Kryerja e procedurave diagnostike
34. Një pacient i verbër u pranua në kardiologji. Cili nga veprimet e mëposhtme të infermieres promovon më së miri përshtatjen ambientale?
- Flit me ngadalë dhe me zë të ulët duke qëndruar përballë pacientit
 - Vendos një shenjë tek dera që tregon që pacienti është i verbër
 - Shpjegoi zhurmat dhe ambientin fizik që e rrethon
 - Jepi instruksione të qarta të thjeshta dhe koncize
35. Infermierja observon një pacient i cili lëviz trupin dhe duart, duket i tendosur dhe me vetulla të ngrysura. Cila është mënyra më e mirë për infermierin që të interpretojë këto shenja jo verbale?


- a. Të thotë: “Dukeni i tendosur, a mund të më thoni nëse diçka ju ka nervozuar ose frikësuar?”
 - b. Pyet: “Dukeni i mërzhitur, a do të dëshironi ndonjë medikament që t’iu qetësojë sado pak?”
 - c. I thotë: “Dukeni i shqetësuar, çfarë po ju shqetëson?”
 - d. Pyet: “Pse jeni kaq nervoz dhe i lëvizur?”
36. Cila nga vlerësimet do të mbështesë diagnozën infermiere *Dëmtim të Integritetit të Lëkurës* e lidhur me drenimin purulent nga plaga:
- a. Të rrahurat e zemrës 88 në minutë
 - b. Plaga që po shërohet normalisht
 - c. Temperature orale 38.3°C
 - d. Mbulesa e plagës e thatë dhe pa shenja
37. Një pacient e ka tensionin 152/86 mmHg. Infermierja dokumenton presionin e pulsit si:
- a. 66 mmHg
 - b. 238 mmHg
 - c. 86 mmHg
 - d. 152 mmHg
38. Infermierja po kryen vlerësimin paraoperator. Cila nga thëniet e klientit duhet të lajmërojë infermierën për prezencën e faktorëve të riskut në komplikacionet post operatore?
- a. “Kam 2 ditë që nuk kam ngrënë asgjë të fortë”
 - b. “Nuk kam kryer asnjëherë ndonjë ndërhyrje kirurgjikale”
 - c. “Kam kryer një operacion 2 vjet më parë dhe nuk do të dëshiroja të kryeja një tjetër”
 - d. “Kam rralluar cigaret nga 2 paketa në 1 paketë në ditë”
39. Një mjek urdhëroi matjen e sasisë së urinës çdo orë tek një pacient post operator. Infermieri dokumenton sasinë e 2 orëve si: ora 8 – 50 mL, ora 9 – 60mL. Në bazën e kësaj sasive çfarë veprimi duhet të ndërmerret infermieri?
- a. Të vazhdojë të monitorojë dhe dokumentojë sasinë e urinës çdo orë
 - b. Të njoftojë mjekun
 - c. Të irrijojë kataterin urinar
 - d. Të risë shpejtësinë e infuzionit intravenoz
40. Një pacient me AIDS zhvillon pneumoni. Cila nga diagnozat infermiere ka prioritetin më të lartë?
- a. Dëmtim i shkëmbimit të gazeve
 - b. Dëmtimi i membranave orale mukoze
 - c. Imbalancë ushqimore: më pak se kërkesat trupore
 - d. Intolerancë ndaj aktiviteteve
41. Një pacient vjen në klinikë për të kryer testet e alergjisë. Pse përdoret injeksoni intradermal për këtë lloj testi?

- a. Injeksoni intradermal është më pak i dhimbshëm
 - b. Medikamentet intradermale janë më të lehta për tu administruar
 - c. Medikamentet intradermale difuzohen me më shpejtësi
 - d. Medikamentet intradermale difuzohen më ngadalë
42. Cili nga anëtarët e skuadrës së kujdesit shëndetsor është përgjegjës për të marrë konsentin e informuar të pacientit?
- a. Infermieri
 - b. Mjeku
 - c. Infermieri që punon tek zyra e mjekut
 - d. Asistenti i mjekut
43. Infermierja sapo ka hequr kateterin intravenoz të një pacienti sepse lëngjet janë infiltruar në krah. Mjeku urdhëroi kompresa të ngrohta. Bazuar në principin e kompresave të ngrohta dhe të ftohta infermieri duhet:
- a. Të mbajë vendin e mbuluar me kompresa të ngrohta në vazhdimësi
 - b. Të largojë kompresat e ngrohta pas 20 minutash për së pakun 15 minuta
 - c. Alternon kompresa të ngrohta me kompresa të ftohta
 - d. E pyet dhe njëherë mjekun pasi kompresat e ngrohta rrisin edemën
44. Mjeku urdhëroi kinezoterapi për një pacient me kongestion pulmonar. Në cilën kohë të ditës infermieri duhet të planifikojë kinezoterapinë?
- a. Pas ushqyerjes
 - b. Para ushqyerjes
 - c. Kur ka kohë pacienti
 - d. Kur ka kohë infermierja
45. Një pacient u pranua me shenjat vitale të mëposhtme, temperature 38.9, të rrahurat e zemrës 144/min dhe të çrregullta, shpejtësia respiratore 26/min. Cila nga diagnozat infermierore merr prioritetin më të lartë kur përgatitet plani i kujdesit?
- a. Ulje e outputit kardiak
 - b. Termorregullim i pasuksesshëm
 - c. Frymëmarrje jo efektive
 - d. Perfusion renal jo efektiv
46. Një infermiere po fillonte mësimdhënien para operatore kur klienti pati një thirrje në telefon nga puna. Kur ajo filloi mësimdhënien klienti dukej i mërzitur. Cila nga të mëposhtmet është mënyra më terapeutike për të iniciuar bisedën.
- a. Inkurajo klientin që të verbalizojë mërzitjen dhe ndjenjat dhe më pas fillo mësimdhënien kur klienti është i aftë të dëgjojë.
 - b. I thotë klientit se është më e rëndësishme që të përqëndrohet në mësimdhënien paraoperative se kjo do ta ndihmojë që të shërohet më shpejt
 - c. I thotë klientit se çfarëdo që të jetë duke ndodhur në punë duhet të zgjidhet në vendin e punës

- d. Inkurajon klientin që të përdorë procesin e zgjidhjes së problemeve
47. Kur kujdeset për të komunikuar me një pacient të pavetëdijshëm, infermieri duhet të vlerësojë të kuptuarit e pacientit nëpërmjet:
- Përdorimit të gjesteve dhe pikturave
 - Bisedon dhe shpjegon çdo gjë me një ton të moduluar
 - Drejton pyetje me përgjigje “jo” ose “po” dhe observon përgjigjet joverbale si tundjen e kokës, lëvizjen e gishtave.
 - I drejton klientit pyetje “open-ended” dhe pret për përgjigje.
48. Si mund të ndihmojë infermierja më së miri një pacient që të ndihet se po merr kujdes cilësor?
- Duke kryer ndërhyrje konfortuese
 - Duke zbatuar me korrektësi planin e kujdesit multidisiplinar
 - Duke dhënë kujdes të individualizuar
 - Qëndron pozitive kur jep kujdes
49. Një pacient që është nën terapi me antidepresivë ankohet për konstipacion. Infermieri gjykon mbi gjendjen e klientit duke përdorur të menduarit kritik. Cila nga më të mëposhtmet është shembulli më i mirë i gjykimit?
- Konstipacioni është efekt anësor i terapisë me antidepresivë
 - Megjithëse konstipacioni është efekt i shpeshtë anësor, por pacienti ka qënë me këtë terapi për një muaj dhe tani po ankohet? Me duket se e bën për të kërkuar vëmendje.
 - Klienti ankohet gjatë gjithë kohës dhe kjo është ankesa e rradhës.
 - Konstipacioni i vazhdueshëm është i rrezikshëm dhe mund të shkaktojë bllokim të ileusit dhe ileus parolitik
50. Cila nga shembujt e mëposhtëm tregon mënyrën intuitive të zgjidhjes së problemit
- Infermierja observon klientin sepse ajo e ‘ndjen’ që gjërat nuk do të shkojnë mirë.
 - Infermierja, provon disa mënyra për të zgjidhur një problem.
 - Infermierja së pari kërkon dhe me pas zhvillon një ndjenjë rreth zgjidhjes së problemeve
 - Infermierja që ka pasur më parë experienca të tilla aplikon zgjidhjen rutinë
51. Një pacient kupton shumë pak shqip dhe në spital nuk ka përkthyes. Çfarë alternative duhet të përdoret nga infermierja për të rritur komunikimin
- Të flasë me zë të lartë me klientin
 - Të përdorë një laps dhe një letër për të shkruar informacionet
 - Të përdorë foto dhe gjeste (joverbale) për të komunikuar
 - Të flasë ngadalë dhe përballë klientit
52. Infermieri hyn në dhomën e pacientes dhe e pyet atë se si ndihet këtë mëngjes. Pacientia thotë: “Jam pak nervoze”. Cila do të ishte përgjigja më e mirë e infermieres;
- “Pse ndihesh nervoze?”
 - “Sigurisht që dukeni nervoze?”
 - “A doni t’iu fërkoj kurrizin?”

- d. “Çfarë doni të thoni me fjalën ‘nervoze’ ?”
53. Kur përpiqesh për të krijuar lidhjen infermiere - pacient qellimi yt i dëshiruar është:
- Krijimi i një miqësie
 - Të bësh pacientin të ndihet komfort
 - Lëvizja drejt rikthimit të shëndetit
 - Mësimi se si të njohësh një person
54. Mënyra më e mirë për t'i siguruar mbështetje emocionale një pacienti që është i nxehur dhe i mërzhitur është:
- Ta mbrosh pacientin nga të qënit i mbidëgjuar duke e intervistuar në privatësi
 - Ulu në një pozicion relaksi në nivelin e syve të pacientit dhe bisedo me të
 - Lejo pacientin që të shprehë shqetësimet e tij
 - Observo pacientin për shenja stresi dhe ankthi
55. Rrethi i konfidencialitetit me të cilët infermieri duhet të ndajë informacionin rreth pacientit janë:
- I gjithë stafi infermieror
 - Stafi i pavionit që është përgjegjës për kujdesin ndaj pacientit
 - Çdo person qe ka diplomë në infermieri
 - Çdo anëtar i familjes që ka të bëjë me pacientin
56. Shqetësimi më i madh i një infermieri kur i referohet një pacienti që është duke u shtruar në spital është
- Rregullimi i transportit të pacientit
 - Njoftimi i ambulancës se ajo do ta kthejë pacientin
 - Të komunikuarit e informacionit pacientit
 - Organizimi i çdo shërbimi në mënyrë që të sigurohet kujdes i vazhdueshëm për pacientin
57. Kur një i rritur arsyeton se duhet të lërë spitalin kundër këshillës së mjekut, cila nga thëniet e mëposhtme do të jetë e vërtetë:
- Ai nuk do të largohet nga spitali deri sa mjeku ta examinojë atë
 - Ai mund të lërë spitalin vetëm pasi të ketë firmosur një formular të posatshëm
 - Ai mund të largohet sepse ai nuk mund të mbahet forcërisht në spital
 - Ai mund të largohet pasi të merret premtimi i tij.
58. Përgjegjësia infermiere kur një pacient dëshiron të largohet nga spitali kundër këshillës së mjekut është:
- Infermieri duhet t'i shpjegojë pacientit se ai mund të largohet nga spitali pasi të shihet nga mjeku
 - Infermieri sigurohet që mjeku është lajmëruar dhe pacienti ka firmosur formularin e posatshëm
 - Infermieri shkruan kërkesën në kartelën e pacientit dhe pacienti e firmos atë

- d. Administrata e spitalit ose kryeinfermieri lajmëron mjekun se pacienti i tij është larguar nga spitali.
59. Veprimi më i mirë infermior kur infermieri konstaton se pacienti nuk e kuptoi ose e keqkuptoi mjekun është:
- Kontakton mjekun dhe i shpjegon se pacienti ka nevojë për më shumë informacione
 - Mendon që pacienti është konfuz dhe nuk ka nevojë që ti shpjegojë me tepër
 - Informon kryeinfermierin se pacienti nuk ka kuptuar asgjë por është i qetë
 - I shpjegon pacientit se mjeku është i zënë dhe nuk ka kohë që t'i japë më tepër informacione
60. Cili është qëllimi i rivlerësimit të të dhënave
- Të verifikojë se të dhënat janë të sakta dhe aktuale
 - Të sigurohet që klienti i kuptoi pyetjet e intervistës
 - Të bëjë pacientin të ndihet rehat
 - Të kompletojë dokumentacionin
61. Gjatë fazës së planifikimit të procesit infermior infermieri duhet të performojë cilin aktivitet?
- Të dokumentojë të dhënat
 - Të zhvillojë qëllimet e kujdesit
 - Të mbledhë të dhënat
 - Të kryejë ndërhyrjet
62. Një pacient vjen në ambulancë për vizitë rutinë. Për të vlerësuar refleksin gag të pacientit infermieri duhet të:
- Vendosë një spatulë në majën e gjuhës dhe t'i thotë pacientit të thotë "aaa"
 - Vendosë spatulën lehtësisht në aspektin posterior të gjuhës
 - Vendosë spatulën në mes të gjuhës dhe ti kërkojë pacientit të kollitet fort
 - Vendosë spatulën në ovula
63. Një infermiere që punon në një pavion pediatrik është një rol model ekselent për kolegët e saj. Ajo inkurajon ata të marrin pjesë në procesin e marrjes së vendimeve në pavion dhe i ndihmon në përmirësimin e aftësive të tyre klinike. Infermieri po funksionon suksesshëm në cilin rol?
- Menaxher
 - Autokratik
 - Lider
 - Autoritet
64. Cila karakteristikë klinike ndikon në bashkëpunimin e pacientit?
- Njohuritë për medikamentet
 - Faktorët psikosocialë
 - Lidhja infermiere-pacient
 - Ashpërsia dhe zgjatja e sëmundjes
65. Cila nga situatat në rastet e mëposhtme do të kërkojë një diagnozë aktuale infermiore:

- a. Një pacient që ka kaluar Ethe Reumatike në fëmijëri do të kryejë ndërhyrje dentale
 - b. Një pacient që ka dhimbje abdominale, diarre dhe të vjella
 - c. Një familje është gati që të merret me zgjidhjen e konfliktit
 - d. Një adoleshent i shtruar në spital që nuk e viziton familja
66. Cila është karakteristika kryesore e diagnozës infermiere:
- a. Ato referojnë kushtet që infermieret janë të edukuara dhe të licensuara për të trajtuar
 - b. Ato janë gjykime të bëra përpara se të mblidhen të dhënat
 - c. Ato përfshijnë disa funksione të pavarura infermiere, të cilat mund të orientohen nga mjeku
 - d. Ato duhet të aprovohen nga mjeku dhe klienti
67. Cili nga strukturat e më poshtme nuk është pjesë e sistemit kondaktiv kardiak?
- a. Bundle of HIS
 - b. Fibrat Purknje
 - c. Nodusi Sinoadrial
 - d. Epicardiumi
68. Kur rritet outputi kardiak?
- a. Gjatë ushtrimeve
 - b. Pas ushtrimeve
 - c. Pas marrjes së një medikamenti inotropic negative
 - d. Nëse të rrahurat e zemrës janë 60/min
69. Sa është shpejtësia e rrahjeve kardiake?
- 
- The image shows an ECG tracing on a standard grid. The rhythm is regular. The rate is approximately 70 bpm. The P waves are visible before each QRS complex, and the T waves are visible after each QRS complex.
- a. 50 r/m
 - b. 65 r/m
 - c. 70 r/m
 - d. 80 r/m
70. Cila nga thëniet e mëposhtme duhet të përfshihet kur flasim për shëndetin për faktorët që ndikojnë sistemin kardiovaskular
- a. Ambientet e ftohta çojnë në konstruksion të vazave periferike të gjakut
 - b. I nxehti rrit rezistencën e qarkullimit të gjakut kështu që outputi kardiak rritet
 - c. Nikotina ul rezistencën vasculare periferike
 - d. Alkoli është një stimulant respirator dhe rrit respiracionin

71. Cila është domethënia e një pacienti me insuficienc kardiake, që fle me 3 jastëk?
- Forcon kollën dhe frymmarrjen e thellë
 - Të flesh me 3 jastëk siguron komfort sepse ka më pak presion në sacrum
 - Ndoshta është një zakon i klientit dhe nuk ka ndonjë domethënie
 - Dyspnea nocturnale shfaqet tek klientët me insuficiencë kardiake dhe gjumi me 3 jastëk qetëson simptomat
72. Cila nga të mëposhtmet nuk është shenjë kardinale e arrestit kardial
- Cianoza
 - Apnea
 - Mungesa e pulsit carotid ose femoral
 - Dilatacioni i pupilave
73. Cila nga të mëposhtmet nuk është një faktor rreziku i pamodifikueshëm për sëmundjet koronare të zemrës?
- Bislipidemia
 - Trashëgemia
 - Jeta sedentare
 - Stresi
74. Cila nga testet diagnostike të mëposhtme ndihmon në diferencimin ndërmjet dhimbjes së gjoksit e shkaktuar nga infarkti i miokardit ose nga dhimbja e pleuritit?
- Creatin kinasa CK
 - Ecocardiografia ECHO
 - Angiografia
 - Gazet arteriale të gjakut
75. Cila nga thënie e mëposhtme është e vërtetë rreth vazhdimësisë shëndet sëmundje?
- Kufi mund të egzistojnë për disa individë dhe kjo varet nga perceptimi i tyre
 - Perceptimi i personit për veten do të ndikojë vendndodhjen e tij në këtë vazhdimësi
 - Personat mund të lëvizin para dhe pas në këtë vazhdimësi dhe kjo varet nga stadi i jetës së tyre
 - Ka kufij të qartë që ndajnë shëndetin e varfër ose sëmundjen nga shëndeti i mirë
76. Një infermiere po shikon gjetjet nga examini fizik i një pacienti që janë dokumentuar në kartelë. Cila nga të dhënat e dokumentuara është e dhënë objektive:
- Pacienti ka përjetuar dhimbje migrenoze
 - Pacienti ka vështirësi për të urinuar
 - Pacienti merr paracetamol
 - Pacienti ka rash në gjoks dhe në krahë
77. Cili nga të mëposhtmit është një variabël i brendshëm që influencon statusin e shëndetit?
- Perceptimi që zakonet shëndetsore janë më të mira se sa mjekësia tradicionale perëndimore

- b. Rolet në punë
 - c. Tendenca e mësuar për të kërkuar këshilla shëndetsore
 - d. Përmbajtja gjenetike influencon temperamentin e brëndshëm dhe potencialin intelektual
78. Cila nga faktorët e mëposhtëm modifikon përceptimin individual për të ndërmarrë veprime mbi shëndetin?
- a. Pozicioni gjeografik si klima dhe gjelbërimi
 - b. Moshë, presioni social dhe njohuritë rreth sëmundjes
 - c. Zgjedhjet mbi stilin e jetës të tilla si higjiena dhe ngjarjet krijuese
 - d. Stresi dhe reaksionet emocionale
79. Cili nga të mëposhtëmit është një aspekt i rolit të të sëmurit?
- a. Pacienti nuk është i detyruar të përpiqet dhe të përmirësohet me shpejtësi
 - b. Pacienti është përgjegjës për kushtet e tij
 - c. Pacienti nuk përjashtohet nga disa detyra dhe role
 - d. Pacienti e ka për detyrë të kërkojë ndihmë nga kompetentët
80. Cila është ndërhyrja infermierore më e përshtatshme për një klient i cili nuk bashkëpunon me trajtimin?
- a. Të gjithë pse klienti nuk po ndjek trajtimin
 - b. Të gjithë informacion dhe të rregullosh keqkuptimet
 - c. Të tregosh shqetësim të sigurtë rreth vendimeve të pacientit
 - d. Të sigurosh që klienti është i aftë të performojë procedurat e nevojshme
81. Cila nga problemet e mëposhtme influencon bashkëpunimin e kujdesit shëndetësor me adoleshentët?
- a. Aftësitë e tyre të pamjaftueshme për të zgjidhur problemin
 - b. Prezenca e burimeve dhe mbështetja nga prindi
 - c. Përceptimi i pasojave rreth veprimeve të tyre
 - d. Orientimi në të ardhmen
82. Cili nga të mëposhtmet nuk është një efekt i sëmundjes mbi një individ?
- a. Ndryshimet ambientale
 - b. Ndryshimet emocionale dhe të sjelljes
 - c. Ndryshimi në vetë-konceptim
 - d. Humbja e autonomisë
83. Cila nga aktivitetet e mëposhtme infermierore rikthen shëndetin?
- a. Edukimi i një gruaje të re rreth rëndësisë së vet egzaminimit të gjoksit
 - b. Ti mësosh studentëve në shkollën e mesme për të parandaluar sëmundjet seksualisht të transmetueshme
 - c. Të edukosh një grup prindërisht të fëmijëve se si të parandalojnë aksidentet
 - d. Ti mësosh një individ anksioz strategjitë e rritjes së adaptimit

84. Në moshën e vjetër individi përjeton shumë humbje të tilla si ndryshime fizike dhe të kapacitetit mendor. Si ndikon mbi të moshuarit aspekti i humbjes?
- Mënyra se si të moshuarit mendojnë për veten është e dobët
 - Është e pritshme, kështu që imazhi rreth vetes tek të moshuarit nuk ndikohet
 - Imazhi i të moshuarve rreth vetes mund të përmirësohet duke marrë pjesë në këto ndryshime
 - Personaliteti është i stabilizuar në moshën e vjetër kështu që imazhi rreth vetes nuk ndryshon
85. Një pacient, fëmija i të cilit vdiq në një aksident me makinë thotë: “E di që duhet të hidhërohem por unë nuk kam kohë. Fëmijët e tjerë kanë nevojë për mua dhe unë nuk mund të qaj.” Përgjigjia më terapeutike e infermieres do të jetë:
- “Ju keni të drejtë, ju duhet të kaloni hidhërimin. Pse nuk merrni disa ditë pushim dhe të takoni një psikolog? Ai do t’ju ndihmojë ju dhe fëmijët tuaj.”
 - “Çfarë ju po bëni është e mirë për fëmijët por jo për ju. Ju duhet të merrni kohën tuaj dhe të hidhëroheni ose ndryshe ju do të sëmureni”
 - “Duhet të jetë shumë e vështirë për ju dhe fëmijët tuaj. Duket sikur ju po përpiqeni shumë për të fshehur mërzitjen tuaj. Sido që të jetë, të kalosh hidhërimin është shumë e rëndësishme për shëndetin tuaj.”
 - “Të përpiqesh të kalosh hidhërimin është e rëndësishme që ju të jeni të shëndetshëm. Fëmijët kanë nevojë që ju të jeni të shëndetshëm. Duhet të shikoni efektet që humbja ka mbi ju dhe fëmijët tuaj. Ndoshta mund të jetë e nevojshme që të takoni një psikolog.”
86. Cila nga këto arsye janë faktor kontribues në mos kalimin e hidhërimit pas një vdekje?
- Hidhërimi i një individi përpara se të amputojë një ekstremitet
 - Një individ mbijeton pas një zjarri që vrau të gjithë anëtarët e tjerë të familjes së tij
 - Antarët e familjes kanë rituale të ndryshme për të ndjekur pas vdekjes
 - Besimet kulturore lejojnë shprehjen emocionale të hidhërimit
87. Bashkëshortja e një pacienti në mënyrë të vazhdueshme ka refuzuar të besojë se sëmundja e të shoqit është terminale dhe asgjë nuk mund të bëhet për të parandaluar vdekjen. Në cilën mënyrë infermieri mund të ndihmojë bashkëshorten e pacientit?
- Të egzaminojë së pari sjelljen e tij/saj për t’u siguruar që dhe ju nuk jeni në mohim
 - E lejon bashkëshorten të mohojë sëmundjen terminale në mënyrë që pacienti të mos ndihet i abandonuar
 - Ofrimi i mbështetjes shpirtërore
 - Inkurajon bashkëshorten të socializohet me të tjerët që kanë qënë në të njëjtën situatë
88. Kur vlerëson një pacient i cili do të shkojë në *Risektimin e Mushkërisë* infermieri kupton domethënien e humbjes së një pjese trupore. Cila nga pyetjet e mëposhtme është më e përshtatshme që të drejtohet nga infermieri gjatë vlerësimit?
- “Çfarë ndryshimi mendoni ju, do të shkaktojë ndërhyrja kirurgjikale në jetën tuaj?”
 - “Çfarë do të bëni pas ndërhyrjes kirurgjikale?”
 - “A ka diçka që unë mund ta bëj për tju ndihmuar?”

- d. "A keni pësuar ndonjë humbje tjetër në të shkuarën?"
89. Cila do të ishte një strategji terapeutike për të komunikuar me një pacient që po humb jetën?
- Inkurajon pacientin të rri sa më qetë që të jetë e mundur për të kursyer energji
 - Qëndro me pacientin dhe flit rreth ngjarjeve të bukura
 - Prano diskomfortin ose vuajtjen e klientit
 - Ofro siguri dhe simpati
90. Cila do të ishte rruga më e mirë e administrimit të medikamentëve të dhimbjes tek një person që po ndërron jetë?
- Infusion intravenoz
 - Oral
 - Subcutaneous
 - Intramuscular
91. Një infermiere po kryen një vlerësim të statusit circulator pasi një pacient po ankohet për dhimbje të papritur gjoksi dhe dispne. Çfarë lloj vlerësimi po kryen infermierja?
- Parësor
 - I fokusuar në problem
 - Emergjent
 - Të vazhduar
92. Cila nga shëmbujt e mëposhtëm është e dhënë objektive?
- Bashkëshortia e një pacienti thotë: "Ai nuk mund të mbajë në dorë as furcën e dhëmbëve ose një laps ose një objek tjetër sado të vogël."
 - Bashkëshortia e një pacienti thotë: "Ai është shumë mosbashkëpunues"
 - Pacienti thotë: "E di që nuk jam sëmurë. Ilacet që më jepni ju, po më çmëndin."
 - Pacienti thotë: "Më vjen për të vjell"
93. Cila nga të mëposhtmet është një shëmbull i të dhënave nga një burim parësor?
- Pacienti
 - Familjarët e pacientit
 - Kartela e pacientit
 - Mjeku i pacientit
94. Cila nga të mëposhtmet është shëmbull i një pyetje të hapur?
- A mund të më thoni ku ju dhëmb?
 - Çfarë do të dëshironit të bëni tani?
 - Cilat situata shkaktojnë ankth tek ju?
 - Kur ndodhi kjo?
95. Cili është qëllimi i fazës së hapjes të një interviste?
- Të kontraktosh me të intervistuarin
 - Të bësh pacientin t'i përgjigjet pyetjeve

- c. Ta bësh intervistuesin të kuptojë se infermierja do kujdeset
 - d. Të fillosh të themelosh besimin dhe të orientosh të intervistuarin
96. Vlerësimi përfshin cilën nga aktivitetet e mëposhtme?
- a. Biseda, shkrimi, organizimi dhe vlerësimi
 - b. Komunikimi, shkrimi, dëgjimi dhe organizimi
 - c. Mbledhja, organizimi, vlefshmëria dhe dokumentimi
 - d. Komunikimi, dëgjimi, mbledhja, dokumentimi
97. Kur përqipesh për të krijuar lidhjen infermiere - klient qëllimi yt i dëshiruar është:
- a. Krijimi i një miqësie
 - b. Të bësh pacientin të ndihet komfort
 - c. Lëvizja drejt rikthimit të shëndetit
 - d. Mësimi se si të njohësh një person
98. Diana është një paciente e re e diagnostikuar me diabet. Ajo duhet të mësojë të administrojë injeksionet e insulinës. Kur do të jetë koha më mirë për të filluar këtë mësimdhënie
- a. Një ditë para se të dalë nga spitali
 - b. Gjatë kohës që vinë fëmijët për ta parë
 - c. Menjëherë pasi ajo diagnostikohet
 - d. Dy ditë pasi ajo diagnostikohet në kohën që burri i saj vjen për ta parë.
99. Planifikimi i daljes nga spitali fillon:
- a. Kur mjeku i pacientit jep urdhër për dalje
 - b. Kur pacienti pranohet në spital
 - c. Kur pacienti fillon të pyesë rreth planit të daljes
 - d. Kur identifikohen të gjitha nevojat specifike të pacientit.
100. Cili nga të mëposhtmet nuk është hap i procesit të marrjes së vendimeve
- a. Vlerësimi i problemit
 - b. Identifikimi i qëllimit
 - c. Vendosja e kritereve
 - d. Peshimi i kritereve
101. Cila është diferenca ndërmjet marrjes së vendimeve dhe procesit infermieror
- a. Ka më shumë hapa në marrjen e vendimeve se në procesin infermieror, dhe marrja e vendimeve përdoret në çdo hap të procesit infermieror
 - b. Nuk kanë ndryshim sepse të dyja kërkojnë planifikim të kujdesshëm
 - c. Të dyja janë procese por marrja e vendimeve është më e thellë
 - d. Procesin infermieror ka diagnozë ndërsa marrja e vendimeve vendos kritere
102. Infermieri po vlerëson një klient për rrezik rrëzimi. Ai/ajo duhet të shikojë:
- a. Informacione mbi qëndrimin dhe balancën
 - b. Politikat institucionale rreth lidhjes

- c. Historinë psikosociale familjare
- d. Preferencat e dietës

103. Koha në dispozicion për dorëzimin e turneve është:

- a) 20 minuta
- b) Nga nr i pacientëve
- c) Nga gjendja shëndetësore e pacientëve
- d) Të gjitha të mësipërmet

104. Në dorëzimin e turneve kur pacientet janë në gjendje normale nevojitet një kohë raportimi me gojë :

- a) 1 minut
- b) 2 minuta
- c)10 sekonda

105. Në dorëzimin e turneve për pacientët në gjendje të rëndë shëndetësore do të komunikohet në :

- a) Kryeinfermieri
- b) Tek koka e të sëmurit që të shihet edhe gjendja shëndetësore
- c) Të dyja së bashku

106. Dita Botërore e larjes së duarve është:

- a) 15 Maj
- b) 15 Tetori
- c) 15 Marsi

107. Kur ndodh një aksident automobilistik në rrugë, kë njoftojmë urgjent më parë?

- a) Qendrën kombëtare të urgjencës
- b) Urgjencën e Zjarrfikësëve
- c) Policin e qarkullimit rrugor
- d) Të treja së bashku